

ANASH

APPROACHING SCIENCE

ANALET E ALB-SHKENCËS
Numër special,
Shtator 2014

Botim i Institutit Alb-Shkenca
(www.alb-shkenca.org)



Shkenca, faktor i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm shoqëroro-ekonomik

TAKIMI I 9-TË VJETOR NDËRKOMBËTAR I INSTITUTIT ALB-SHKENCA
Prishtinë, 29-31 gusht 2014

Botimi i një **reviste informativo-shkencore shqiptare** u bë i domosdoshëm në kushtet në të cilat ndodhet dhe zhvillohet sot shkenca në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe në një kohë kur numri i anëtarëve të Forumit Alb-Shkenca (<http://www.alb-net.com/mailman/listinfo/alb-shkenca>) është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Shumica e këtyre anëtarëve janë studiues, pedagogë e studentë pasuniversitarë shqiptarë që kryejnë veprimtarinë e tyre shkencor në vende të ndryshme të botës. Por ka edhe shumë anëtarë të Alb-Shkencës që kontribuojnë në gjallërimin e jetës shkencore në universitetet dhe institucionet shkencore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Revista e Alb-Shkencës synon të bëjë të njohur në të gjithë botën shqiptare aktivitetin shkencor mjaft të larmishëm dhe shpesh herë shumë cilësor, të studiuesve shqiptarë kudo që ndodhen në botë. Nëpërmjet përzgjedhjes së kujdesshme të shkrimeve, në këtë revistë kemi pranuar për botim vetëm ato shkrime që kalojnë në nanofiltrin e cilësisë. Këtu pra do të pasqyrohet ajo çka është më e shquara e kontributit shkencor shqiptar në këto vite të para të shekullit XXI. Kjo revistë e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, botim i **Institutit Alb-Shkenca** (www.alb-shkenca.org), është menduar t'i shërbejë një auditori të gjerë intelektualësh e dashamirësish të shkencës në përgjithësi dhe të asaj shqiptare në veçanti. Anëtarët aktualë të Institutit vendosën ta quanin këtë revistë me emrin simbolik: **ANASH—Approaching Science**.

Dikush mund të pyesë: Përse emri ANASH? Ai është shkurtësë e emrit “Analet e Alb-Shkencës” që është edhe emri zyrtar i kësaj reviste. Por fjala shqip “anash” merr një kuptim simbolik fare të veçantë kur vendoset përpara shprehjes në anglisht “Approaching Science”.

Fjala “anash” ka edhe një kuptim të dytë simbolik që reflekton të vërtetën, atë që diaspora intelektuale e shkencore shqiptare është lënë pakëz mënjanë nga vëmendja e politikëbërësve dhe pushtetarëve shqiptarë e ndoshta edhe është harruar për shkak të largësisë e kohës nga trojet e atdheut.

Por e vërteta është që edhe pse ndodhen larg, anash realitetit të përditshëm të shqiptarëve të Ballkanit, intelektualët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë atdheut shërbejnë jo vetëm si **ambasadore** të shkëlqyer por vëzhgojnë e ndjekin nga afër ecuritë në çdo fushë të jetës dhe shoqërisë shqiptare. Të organizuar tek Alb-Shkenca ata gjithmonë e më shumë po kërkojnë të marrin pjesë aktivisht dhe të ndihmojnë për një jetë më të mirë të shqiptarëve kudo që ndodhen. Botimi i revistës ANASH është shprehje e qartë e këtij angazhimi serioz të **diasporës shkencore** që po përpiqet përditë e më tepër të kontribuojë në zhvillimet jo vetëm të shkencës dhe arsimit por edhe të shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Revista ANASH përfshin një larmi artikujsh prej fushave nga më të ndryshmet shkencore të përgatitur nga studiues të afirmuar apo studentë pasuniversitarë shqiptarë që kontribuojnë në shkencën botërore edhe në disiplina shkencore nga më të rejat si nanoteknologjia, ekologjia dhe informatika, por edhe në fushat klasike të shkencës si fizika, veterinaria, ekonomia dhe gjuhësia (albanologjia).

Ju urojmë të gjithëve lexim të këndshëm.

Redaktorë shkencorë: Nebi Caka, Prof. Dr., Prishtinë, Kosovë
Nikolla P. Qafoku, Ph.D., Richland, SHBA
Robert T. Magari, Ph.D., Florida, SHBA
Përgatija grafike: Roland Lelaj, Toronto, Kanada

Programi i përgjithshëm i Takimit të 9-të vjetor ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca

Tema bosht:

“SHKENCA, FAKTOR I RËNDËSISHËM I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM SHOQËROR-EKONOMIK”

Takimi u organizua në bashkëpunim me:

Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Kosovë
Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë
Universitetin Publik “Isa Boletini”, Mitrovicë

Takimi përmbante 11 (njëmbëdhjetë) konferenca shkencore të cilat zhvilluan punimet në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Në kuadër të secilës konferencë u organizuan disa simpoziume (seanca të veçanta). Konferencat e zhvilluara këte vit ishin:

Konferenca e Seksionit të Shkencave të Filologjisë, Historisë dhe Kulturës
Konferenca e Seksionit të Shkencave të Drejtësisë
Konferenca e Seksionit të Shkencave të Bujqësisë
Konferenca e Seksionit të Shkencave të Mjedisit
Konferenca e Seksionit të Shkencave të Ekonomisë
Konferenca e Seksionit të Shkencave të Natyrës
Konferenca e Seksionit të Shkencave të Mjekësisë
Konferenca e Seksionit të Shkencave Inxhinierike dhe të Teknologjisë së Informacionit
Konferenca e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Politike
Konferenca ndërdisiplinore: “Terminologjia profesionale-veprimtari ndërdisiplinore”
Simpoziumi: “Informatika në shkencat e tjera”

Aktivitete të tjera ishin:

Mbledhja e Administratës Qendrore të Institutit Alb-Shkenca.
Mbledhja e Bordit Drejtues dhe
Mbledhja e Përgjithshme e Institutit.

Kumtesat dhe i gjithë komunikimi gjatë Takimit Ndërkombëtar zhvillohen në gjuhën shqipe dhe angleze.

Përshëndetja e hapjes nga Prof. Dr. Shpresa Hoxha, Kryetare e IASH - Prishtinë

Të nderuar pjesëmarrës të Takimit të IX ndërkombëtar vjetor të IASH,
Mysafirë dhe miq të nderuar,
Zonja dhe zotërinj,

Jam e nderuar dhe e privilegjuar, që në emër të Këshillit Organizativ të Prishtinës, Kryesisë së Tiranës, Kryesisë së Shkupit dhe të gjithë studiuesve, të përshëndes këtë manifestim solemn, Takimin e IX të Institutit Alb-Shkenca, të organizuar nga Dega e Prishtinës në bashkëpunim me Dekanatin e Fakultetit Ekonomik dhe të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Me përpjekjet tona të gjithanshme shpresojmë se ia kemi dalë mbanë për një organizim të mirë. Falënderoj të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje në këtë takim madhështor. Më lejoni që me këtë rast të përshëndes:

Drejtoreshën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, zonjën Drita Kadriu, njëherazi duke e falënderuar për mbështetje të vazhdueshme, për sigurimin e mjeteve të botimit të librit të përmbledhjeve, sigurimin e konviktit për qëndrim të studiuesve të IASH-it, dhe së fundi edhe për botimin e Revistës “AKTET” të këtij Takimi.

Përshëndetje për:

Ministrin e Arsimit dhe të Shkencës të Republikës së Maqedonisë, Abdylaqim Ademi

Zëvendës Rektorin e UP Prof.dr. Muhamet Malaj

Rektorin e Universitetit të Mitrovicës, z. Alush Musaj

Kryetarin e nderit të IASH-it, Prof.dr. Niko Qafoku

Kryetarin e përgjithshëm të IASH-it, Prof.dr. Gentian Zyberi

Kryetarin e Degës së IASH-it Tiranë Prof. dr. Ardian Maçi

Kryetarin e Degës së IASH-it të Shkupit Prof. dr. Zeqirja Neziri

Dekanin e Fakultetit Ekonomik Prof.dr. Skender Ahmeti,

Dekanin e Fakultetit Juridik Prof.dr. Bajram Ukaj,

duke i falënderuar edhe për lirimin e gjithë hapësirave të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik për zhvillimet e punimeve të Takimeve tona në Prishtinë.

Përshëndetje dhe falënderime njëkohësisht edhe për

udhëheqësit e drejtorët e institucioneve shkencore dhe kulturore, përfaqësuesit e shtëpive televizive dhe të shtypit, të cilët kanë bërë dhe po bëjnë të mundur informimin e opinionit të gjerë për punët dhe zhvillimet e Institutit “Alb-Shkenca” në vijimësi, si dhe gjithë stafin organizues dhe pjesëmarrës të këtij takimi shkencor.

Jemi mbledhur për herë të nëntë në këtë tubim ndërkombëtar të IASH-it, i themeluar vullnetarisht para rreth një dekade me iniciativën e studiuesve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe mbarë diaspora shqiptare, i cili mbledh studiues shqiptarë dhe jo vetëm shqiptarë pothuajse nga të gjitha anët e globit për të prezantuar risitë e tyre në 11 konferenca të fushave të ndryshme studimore.

Duhet theksuar se për arritjet dhe sukseset e deritanishme, meritore janë nismëtarët dhe udhëheqësit e parë të IASH-it, Prof.dr. Niko Qafoku, tani kryetar nderi i IASH-it, Lindita Komani, ish sekretare, Prof.dr. Jahja Kokaj, si dhe shumë studiues dhe bashkëpunëtorë të tjerë shqiptarë, të cilët me angazhim dhe punë të pandërprerë e të pakursyeshme arritën të afrojnë shumë studiues fushash të ndryshme shkencore falë vullnetit dhe dëshirës për përparimin e shkencës dhe të kulturës shqiptare në botë.

Mbështetur në punën vazhdueshme dhe në bashkëpunimin intensiv u vunë themelet e këtij Institucioni shkencor në tri qendra: Tiranë, Prishtinë, Shkup, që mundësuan paraqitjen e të arriturave shkencore, këmbimin e përvojave si dhe krijimin e miqësive të reja në mesin e studiuesve vendorë e të huaj.

Puna dhe angazhimi ynë po bëhet në baza plotësisht vullnetare dhe me përgjegjësi të madhe, ndihmohemi përmes komunikimit elektronik drejt përpjekjeve për t'i paraqitur zhvillimet, risitë dhe të arriturat në të gjitha fushat e studimeve bashkëkohore.

Falë këtij suksesi të arritur bashkërisht me përpjekje të vazhdueshme e sakrifica të mëdha, me një punë të pandërprerë, kanë dalë në dritë botime të shumta: përmbledhje artikujsh shkencorë të studiuesve pjesëmarrës, botimet e AKTEVE deri në pesë vëllime, ku janë përfshirë të gjitha kontributet autentike me vlerë nga Konferencat shkencore të seksioneve të ndryshme,

revista ANASH (Approaching Science) dhe publikimet përbrenda saj, etj., që përbëjnë një thesar të ri të shkencës sot.

Takimi i IX i IASH-it ka rolin e një Kongresi ndërkombëtar, shkencor dhe kulturor me traditë të pasur, të cilën e karakterizojnë vlera të verifikuara shkencore e kulturore. Në fakt është një tubim i rëndësishëm vjetor dhe paraqet të arriturat dhe risitë shkencore të studiuesve shqiptarë, por edhe të huaj nga vende të ndryshme të botës, me një veprimtari shumë dimensionale, duke përfshirë pothuajse të gjitha fushat e studimit përbrenda 11 Konferencave të ndara. Takimi ynë shkencor pasurohet edhe ligjëratat, diskutimet dhe debatet e frytshme shkencore, lidhur me kumtesat, referimet dhe punimet e studiuesve.

Të gjithë pjesëmarrësve të Takimit të IX Ndërkombëtar të IASH-it ju uroj mbarëvajtje në zhvillimet e punimeve dhe suksese të mëtejme.

Fjala përshëndetëse nga z. Abdilaqim Ademi, Ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në Republikën e Maqedonisë

Të nderuar të pranishëm,
I nderuar drejtor i Institutit Alb-Shkenca,
Të nderuar punëtorë shkencorë dhe mysafirë

Ndjem tepër i privilegjuar, si i ftuar të përshëndes Takimin IX Vjetor Shkencor Ndërkombëtar që e organizon Instituti Alb-Shkenca me temë: Shkenca, faktor i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm shoqëroro-ekonomik.

Të nderuar të pranishëm,

Koha e globalizimit ka bërë që shoqëritë gjithnjë e më shumë të investojnë në shkencë, në kërkim, sepse, vetëm nëpërmjet inovacionit dhe dijes mund të arrihet progresi ekonomik dhe organizimi i mirëfilltë shoqëror. Për më tepër duhet të ndjehemi të lumtur që jetojmë në një kohë, e cila mundëson përfshirjen e të gjitha kombeve në një garë shkencore dhe bashkëpunim të pakufishëm. Edhe vendet e rajonit ballkanik, duke qenë të përfshirë në këtë trend mund të arrijnë përparimin e gjithmbarshëm dhe zhvillimin socialo-ekonomik.

Në Republikën e Maqedonisë aktivitetet kërkimore shkencore përfshijnë një rrjet institucionesh arsimore e kërkimore shkencore (publike dhe private): 5 universitete shtetërore, 7 institute publike shkencore, 18 universitete private dhe 10 institute private. Një pjesë e instituteve kërkimore-shkencore dhe e qendrave arsimore shkencore universitare tanimë kanë arritur renome në konkurrencën ndërkombëtare, ndërkaq disa të tjera në mënyrë të shpejtë ecin drejt përmbushjes së kriterëve dhe standardeve ndërkombëtare.

Strategjia dhe programi qeveritar, gjegjësisht i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës i Republikës së Maqedonisë ka pasur dhe ka prioritet krijimin e mundësive të zhvillimit të një bashkëpunimi efektiv midis institucioneve arsimore e kërkimore shkencore vendase me organizatat ndërkombëtare që financojnë programe në fushën e shkencës.

Në dekadën e fundit, Republika e Maqedonisë ka krijuar një përvojë të shkëlqyeshme në fushën e bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar, sidomos me vendet evropiane. Bashkëpunimi ndërkombëtar realizohet përmes HORIZONT 2020, COST, EUREKA, UNESCO, IAEA, LSA etj. Në mënyrë të veçantë duhet theksuar pjesëmarrja e hulumtuesve në Programin Kornizë 7. Hulumtuesit tanë marrin pjesë në 82 projekte me një buxhet prej 7.6 milionë eurosh. Muajin e kaluar Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Komisioni Evropian kanë nënshkruar një marrëveshje për pjesëmarrje në programin Horizont 2020 të rëndësishëm për shkencë dhe inovacion.

Në këtë kontekst vlen për t'u përmendur miratimi i strategjisë rajonale i zhvillimit të kërkimeve shkencore hulumtuese dhe të inovacioneve për Ballkanin Perëndimor. Ky është një dokument strategjik, i cili mundëson tërheqjen e mjeteve financiare që do të investohen në fushën e hulumtimit, zhvillimit dhe të inovacioneve.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në vitin 2011 nisi me implementimin e projektit të furnizimit të instituteve kërkimore-shkencore dhe universiteteve shtetërore me pajisje shkencore mësimore e hulumtuese. Në kuadër të këtij projekti do të sigurohen pajisje për 191 laboratorë. Vlëra e këtij investimi është rreth 41 milionë euro.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës do të përkrahë çdo nismë që favorizon ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor, nxit shkëmbimin e përvojave midis studentëve, kërkuesve të rinj dhe stafëve elitare shkencore. Ne do t'i ofrojmë mbështetje maksimale bashkëpunimit midis kërkuesve shkencorë vendas dhe atyre ndërkombëtarë. Me një fjalë do të përkrahim institucionalisht çdo iniciativë bashkëpunimi dhe projekt kërkimor të përbashkët që çon drejt interesit rajonal e më gjerë.

Shpresoj që ky Takim të jetë i rëndësishëm jo vetëm për të ardhmen e shkencës dhe progresin e përgjithshëm, por të jetë edhe një shtytje drejt përshpejtimit të integritetit të vendeve tona në Bashkimin Evropian.

Fjala përshëndetëse e znj. Drita Kadriu, Këshilltare Politike, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës

Të nderuar zonja dhe zotrinj,
Përfaqësues të institucioneve nga të gjitha trojet kombëtare,
Shkencëtarë dhe hulumtues të të gjitha brezave,

Është nder i veçantë për mua që me rastin e përvjetorit të nëntë të organizimit të Alb-Shkencës t'ju përcjell urimet më të përzemërta duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe suksese të vazhdueshme.

Alb-Shkenca e nisur si një ide nga entuziastët e shkencës dhe hulumtuesit, çdo ditë e më shumë po e shtrin ndikimin dhe për të po rritet nevoja dhe interesimi i shkencëtarëve, hulumtuesve dhe studiuesve nga të gjitha fushat dhe nga të gjitha brezat.

Qeverisja e Alb Shkencës është një shembull për të gjithë. Duke funksionuar në distanca gjeografike të largëta, drejtuesit e saj kanë shfrytëzuar shkencën e teknologjisë për t'iu krijuar mundësi të gjithë studiuesve dhe shkenctarëve të bëhen pjesë e shkencës kombëtare. Gjithsesi, kjo po ndikon në promovimin e shkencës shqiptare dhe me po e shton përfshirjen e shkenctarëve të rinj.

Temat që ju trajtoni vit pas viti janë temat aktuale që po përcjellin botën. Problemet globale dhe shfrytëzimi i shkencës për zhvillimet lokale çdo ditë e më shumë po na ofrojnë sigurinë se Alb-Shkenca po e rrit ndikimin e vet jo vetëm në shoqërinë shqiptare por edhe me gjërë. Shkencëtarët tanë me hulumtimet e tyre po i ofrojnë botës informata për zhvillimet në këtë pjesë të gjeografisë shqiptare dhe në të njejtën kohë po ofrojnë rezultate të cilat ndikojnë në zhvillimet lokale.

Zhvillimi i qëndrueshëm së bashku me zhvillimin e arsimit janë objektiva të këtij mijëvjeçari. Këto objektiva dhe strategji synojnë të arrijnë barazinë sociale në botë por edhe gjithandej ku jeton kombi ynë, barazi e munguar në dekada e shekuj.

Alb-Shkenca këtë vit po e sjell temën po aq të rëndësishme "Shkenca si faktor i rëndësishëm shoqëroro-ekonomik për zhvillim të qëndrueshëm".

Studiuesit e njëmbëdhjetë konferencave shkencore si dhe

simpoziumet e veçanta nxjerrin në pah punën e palodhur të studiuesve. Unë besoj se rezultatet e punimeve do të kenë ndikim në jetën e përditshme. Gjithashtu, rezultatet do t'i ofrohen si informata opinionit publik kombëtar e botëror përmes publikimit në botimet e konferencës sipas standardeve ndërkombëtare.

Kohët e fundit në Kosovë është hapur një debat për cilësinë e arsimit të lartë dhe cilësinë e shkencës dhe hulumtimit. Alb-Shkenca është një shembull i mrekullueshëm se në gjeografinë kombëtare aktualisht po zhvillohet shkencë. Unë besoj se bashkë me periudhën e formësimit të Alb-Shkencës në vazhdimësi është synuar edhe cilësia sipas standardeve ndërkombëtare.

Nga të gjitha pozitat dhe detyrat institucionale që kemi, neve na duhet kurajo qytetare për t'i gdhendur margaritarët më të bukur nga shkëmbi i çmuar i quajtur shkencë kombëtare.

Alb-Shkencës i dëshiroj jetë të gjatë sa vetë njerëzimi, punë të mbarë, suksese të vazhdueshme dhe arritje të majave shkencore.

Fjala përshëndetëse e Prof.asoc.dr. Muhamet Mala

U.D. Prorektor për çështje shkencore

në Universitetin e Prishtinës

Të nderuara zonja dhe zotërinj, studiues dhe shkencëtarë shqiptarë nga e gjithë bota.

Të nderuar pjesëmarrës dhe të gjithë ju që në çfarëdo mënyre jepni kontributin tuaj të çmuar në përparimin dhe zhvillimin e jetës akademike dhe shkencore në përgjithësi.

Me e rastin e hapjes së Takimit të nëntë vjetor shkencor ndërkombëtar të Institutit Alb-shkenca kamë nderin që në emër të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës t'ju përshëndes dhe të shpreh kënaqësinë time për pjesëmarrjen në një ngjarje të rëndësishme për Kosovën dhe jetën shkencore akademike përgjithësisht.

Shkenca dhe zhvillimi shkencor me kryeneçësi kanë vazhduar rrugën e tyre të vështirë në të gjitha civilizimet dhe shoqëritë. Asnjë civilizim, asnjë shtet apo shoqëri kurrë nuk ka mundur të zhvillohet e të përparojë pa përkrahjen që i ka ofruar shkenca dhe veprimtaria hulumtuese në të gjith fushat. Diku më shpejt e diku më ngadalë, por me vendosmëri, shkenca nuk është ndalur asnjëherë së zhvilluari. Shpesh sistemet dhe tekat politike kanë ditur që shkencën ta mbështjellin me petkun ideologjik dhe ta tjetërsojnë për nevoja dhe interesa të ngushta politike. Megjithatë, shkenca gjithnjë ka arritur të dalë fitimtare dhe ta ruajë karakterin e vet pozitiv në shërbim të zhvillimit dhe mirëqenies shoqërore e ekonomike të mbarë njerëzimit.

Nëse në rrafshin e përgjithshëm dalim në këndvështrimin e ngushtë kombëtar të shkencës mund të themi se Kosova si shtet i ri por edhe Shqipëria tashmë 102 vjeçare, në perspektivën e tyre zhvillimore e kanë konceptuar idenë e të qenurit shtete të dijes dhe shkencës dhe pikërisht ky manifestim vërteton pikërisht këtë ide dhe këtë zhvillim.

Në botën e sotme të afrimit të ideve, të këmbimit të mendimeve dhe përvojave, organizimet e tilla ofrojnë mundësinë e unifikimit dhe veprimit të kapitalit intelektual mbarëshqiptar. Shqiptarët para së gjithash kanë arsye dhe vullnet t'i zhdukin barrierat politike dhe ideologjike të së kaluarës dhe të synojnë t'i afrojnë mendimet dhe idetë duke u organizuar dhe vepruar me mbështetje shtetërore dhe

institucionale edhe në kuptimin e zhvillimit të shkencës dhe dijes. Andaj kjo ide duhet t'i prijë çdo perspektive të zhvillimit tonë shoqëror e ekonomik.

Në këtë proces të vështirë e të ngadalshëm, por shumë të rëndësishëm të zhvillimit shkencor, universitetet së bashku me institucionet e tjera të arsimit e shkencës krijuan dhe vazhdojnë të hedhin themelet më të forta intelektuale mbi të cilat ngrihet e ardhmja e shtetit tonë.

Ky takim, i nënti me radhë, i cili kësaj here mbahet këtu në Prishtinë, në përgjithësi ofron një mundësi të mirë për të prezantuar të arriturat shkencore, për të diskutuar për rolin e shkencës në shoqëri dhe për të inkurajuar projekte të së ardhmes. Këtë fakt e dëshmon edhe tema bosht e këtij takimi me titull "Shkenca faktor i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm shoqëroro-ekonomik."

Poashtu, rëndësinë e këtij takimi e shpreh edhe fakti se do të përmbajë plot 11 konferenca shkencore që organizohen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra me disa seanca te veçanta.

Së fundi, përgëzoj organizatorët për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me institucionet shkencore e veçmas me Universitetin e Prishtinës dhe ju dëshiroj suksese në punën tuaj shkencore.

Fjala e mbajtur nga Dr. Niko Qafoku, Kryetar Nderi i Institutit Alb-Shkenca

Të nderuar anëtarë të Institutit Alb-Shkenca,
të nderuar kolegë dhe të ftuar,

Eshtë kënaqësi e madhe për mua t'ju drejtohem juve që po merrni pjesë në Takimin e 9-të të Institutit Alb-Shkenca (IASH) që po i mban punimet e tij në Prishtinë. Konstatoj me gëzim që interesi për takimet vjetore të IASH vazhdon të jetë i lartë, gje që tregohet qartë nga numri i madh i kolegëve pjesëmarrës dhe të ftuarit që kanë mbushur sot këtë sallë, por edhe nga numri i madh i punimeve shkencore (më tepër se 450) që janë pranuar për t'u paraqitur në këtë takim.

Dëshiroj t'ju informoj se drejtuesit e seksioneve shkencore të IASH dhe organizuesit e konferencave shkencore kanë bërë një punë këmbëngulëse për të seleksionuar punimet shkencore më të mira për t'u paraqitur me synimin e rritjes së cilësisë shkencore. Ju ftoj pra të gjithëve që t'i ndiqni prezantimet që do të mbahen në konferencat e seksioneve shkencore si dhe në simpoziumet ndërdisiplinore, duke marrë pjesë aktive edhe në diskutime.

Takimet vjetore të IASH janë bërë tashmë pjesë e pandarë e jetës shkencore të studiuesve shqiptarë dhe kanë krijuar një traditë të shkëlqyer sepse kanë ndikuar, po ndikojnë dhe do të ndikojnë në gjallërimin e jetës shkencore shqiptare, në krijimin e lidhjeve midis kërkuesve shqiptarë nga trojet shqiptare në Ballkan dhe atyre me origjinë shqiptare nga e gjithë bota, si dhe në promovimin e punimeve shkencore të studiuesve të rinj, gjë që mundëson ecjen përpara në karrierën e tyre shkencore.

Takimet vjetore të IASH gjithashtu kanë shërbyer, po shërbejnë dhe do të shërbejnë si tribuna të prezantimit të mendimit elitar shkencor shqiptar në shërbim të konsolidimit të shoqërisë civile dhe nivelit të jetesës në të gjitha trojet ballkanike të banuara nga shqiptarët. Duke vazhduar në këtë traditë, Takimi i 9-të i IASH është një tjetër tubim i rëndësishëm shkencor mbarëkombëtar dhe ndërkombëtar dhe shënon një tjetër arritje të shkëlqyer të Institutit Alb-Shkenca. Takimi jubilar i 10-të do të mbahet në Shkup në periudhën gusht/shtator 2015 dhe shpresoj që ju të gjithë do të merrni pjesë atje.

Përfitoj nga rasti që t'ju kërkoj të gjithëve që të shërbeni

si ambasadorë të IASH në të gjitha rrethet intelektuale apo profesionale ku beni pjesë. Ftoni kolegët, miqtë e studentët tuaj që të anëtarësohen në IASH dhe të marrin pjesë në Takimet vjetore. Sa më shumë kolegë të marrin pjesë e të paraqesin arritjet e tyre në takimet vjetore të IASH aq më mirë realizojmë qëllimet e këtyre takimeve dhe ato të Institutit Alb-Shkenca.

Instituti Alb-Shkenca është një organizatë shkencore shqiptarë që u themelua në vitin 2006 dhe që ka patur një aktivitet të shkëlqyer disavjeçar. Ky institucion me fizionomi unike në botën shkencore shqiptare po punon sistematikisht për përparimin e shkencës dhe të arsimit të lartë në të gjitha trojet shqiptare në Ballkan. Për më tepër, ky institucion po luan me shume sukses rolin e një akademie shkencore mbarëkombëtare e strukturuar në nëntë seksione shkencore, me degë gjeografike në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup dhe që mbështetet nga një rrjet studiuesish me shtrirje globale dhe nga të gjitha fushat e kërkimit shkencor.

Disa muaj më parë u kryen zgjedhjet për në organet drejtuese të IASH. Drejtor i përgjithshëm u zgjodh Dr. Gentian Zyberi (Universiteti i Oslos, Norvegji) dhe sekretar i përgjithshëm u zgjodh Prof. Fatos Ylli (Universiteti i Tiranës, Shqipëri). Në strukturën e re drejtuese është shtuar pozicioni i drejtuesit të administratës qendrore (me cilësinë e zv. drejtorit të IASH). Gjithashtu, u miratua që kryetari i degës gjeografike të IASH ku zhvillohet takimi vjetor të shërbejë në cilësinë e zv. drejtorit. Ky pozicion do të mbahet me rotacion një vjeçar nga drejtuesit e degëve gjeografike në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni). U zgjodhën edhe drejtuesit e rinj të seksioneve shkencore dhe të degëve gjeografike. Informacion i përditësuar për organizimin e IASH dhe drejtuesit e saj mund të gjendet në faqen elektronike: www.alb-shkenca.org

Ju uroj drejtuesve të rinj suksese në punë dhe në realizimin e qëllimeve fisnike të IASH. Jam shumë optimist për të ardhmen e tij dhe për kontributin e vazhdueshëm që do të japë ky institucion i rëndësishëm i botës shkencore dhe intelektuale shqiptare në përmirësimin e kërkimit shkencor, arsimit të lartë, shoqërisë civile dhe cilësisë së jetës për të gjithë shqiptarët që jetojnë në trojet e tyre në Ballkan.

Fjala e mbajtur nga Dr. Gentian Zyberi, Kryetar i Përgjithshëm i Institutit Alb-Shkenca

Të nderuar të ftuar,
Të dashur miq dhe kolegë të Institutit Alb-Shkenca,

Është një kënaqësi që ndodhem sot para jush në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit Alb-Shkenca. Dëshiroj të falënderoj me këtë rast kolegët dhe miqtë për besimin e tyre dhe Nikon për fjalët e mira në adresën time.

Këtë prezantim para jush e kam ndarë në tre pjesë. Ju premtoj se nuk do zgjatem shumë, pasi disa prej këtyre çështjeve do të mbulohen në detaje nga kolegët e tjerë.

Një falënderim për Nikon

Së pari, do të më lejoni të them disa fjalë për ideatorin dhe kryetarin e nderit të Institutit, Dr. Niko Qafoku. Pastaj dëshiroj t'ju njoh shkurtimisht me planet e Institutit për vitet në vijim dhe të flas në lidhje me disa nga zhvillimet në arsimin e lartë. Në fund kam një mesazh personal për të gjithë kolegët të cilët merren me mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Niko, të falënderoj në emër të anëtarëve të Institutit dhe miqve e kolegëve të përbashkët për tre gjëra. Së pari, për vizionin tënd për të hedhur themelet e Institutit dhe për të mbledhur rreth vetes një grup të përkushtuar personash që kanë bërë të mundur organizimin e këtyre veprimtarive shkencore për vite me radhë. Instituti përmbush një nevojë të kërkuesve shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia për të pasur një forum rreth të cilit të bashkohen, të ndajnë rezultatet e kërkimit të tyre shkencor dhe të njihen, miqësohen dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

Së dyti, të lavdëroj për stilin tënd gjithëpërfshirës të drejtimit. Kështu, vendimet në Institut janë marrë vazhdimisht pas konsultimit të gjerë në administratën e Institutit me votat e shumicës së Bordit Drejtues. Besoj se ky është një shembull demokratik për t'u ndjekur nga institucione të edukimit, por edhe nga sektorë të tjerë të jetës publike të shoqërisë shqiptare.

Së treti, të falënderoj për punën e palodhur përgjatë këtyre viteve dhe kohën që ke dhënë me bujari për Institutin dhe nëpërmjet tij për të gjithë studiuesit shqiptarë të mbledhur

rreth tij. Për të gjithë ata që bëjnë kërkim shkencor në një mjedis tejet konkurrues si ai amerikan, në një institucion të mirënjohur të kërkimit shkencor botëror, koha është burimi më i çmueshëm. Atëherë kur ti mund të shkruaje një artikull apo një propozim tjetër për të marrë fonde për të shtyrë përpara karrierën tënde, apo të shpenzoje më shumë kohë me familjen, ti i ke dhënë Institutit kohën dhe energjinë tënde në vitet më të mira e në mënyrë vullnetare për më shumë se një dekadë.

Niko, kjo nuk është lamtumirë, sepse ti mbetesh një nga shtyllat e Institutit si kryetar nderi i tij, si memoria institucionale dhe si urë lidhëse mes diasporës intelektuale, studiuesve shqiptarë dhe strukturave përkatëse shtetërore në shërbim të zhvillimit të kërkimit shkencor shqiptar.

Shumë falemnderit për punën që ke bërë deri tani dhe me kolegët e tjerë do të jetë një kënaqësi që të vazhdojmë të punojmë së bashku në kuadër të Institutit për shumë vite që vijnë.

Planet e Institutit dhe reformat në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor

Më lejoni tani të kaloj në planet e Institutit për vitet e ardhshme dhe të shpreh shkurtimisht disa mendime në lidhje me zhvillimet në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në kuadër të temës bosht të takimit, shkenca si faktor i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm shoqëroro-ekonomik.

Vitin që vjen Instituti Alb-Shkenca do të organizojë Takimin e 10-të dhe do të festojë dhjetëvjetorin e vet të parë. Deri tani Instituti ka funksionuar kryesisht si rrjet i kërkuesve shkencorë, duke përmbushur njëkohësisht dy funksione: dhënien e mundësisë këtyre kërkuesve që të paraqesin punimet e tyre shkencore dhe të njihen me kolegë që punojnë në të njëjtën fushë. Ky është një funksion i rëndësishëm, një integrim pa shumë zhurmë e bujë, por i vërtetë i hapësirës shkencore mbarëshqiptare dhe diçka që Instituti do të vazhdojë ta kryejë edhe në të ardhmen. Kostot financiare për këtë shërbim ndaj shkencës dhe shoqërisë shqiptare kanë qenë minimale, kryesisht në sajë të dedikimit

dhe të punës vullnetare dhe mijëra orëve të shpenzuara nda kolegët e këshillit drejtues dhe administratës së përgjithshme të Institutit! Falënderoj gjithashtu edhe ministritë e arsimit të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe rektorët e universiteteve kryesore në tre shtetet që na kanë përkrahur vazhdimisht në realizimin e këtyre takimeve, duke përfshirë dhe këtë aktivitet. Ne shpresojmë se ky bashkëpunim do të vijë në rritje si sasiore ashtu edhe cilësore.

Janë tre drejtime në të cilat Instituti do të mundohet të japë kontributin e vet, duke shfrytëzuar kapacitetet e kufizuara financiare që ka në dispozicion. Së pari, në vitet që vijnë aktiviteti i Institutit do të zgjerohet në drejtim të trajnimit të studiuesve të rinj në metodat kërkimore dhe në publikimin e punës kërkimore në revista shkencore ndërkombëtare. Kjo do të jetë një pjesë e programit të Takimit, të cilën neve e kemi aplikuar më përpara, por që tanimë synojmë ta kthejmë në një pjesë standarde të programit të Takimit.

Së dyti, fusha tjetër në të cilën Instituti do të mundohet të kontribuojë në fushën e arsimit të lartë është mbështetja e përgatitjes së teksteve bazë mësimore për studentët në fusha të ndryshme të shkencës, sipas nëntë seksioneve shkencore të Institutit. Një numër i madh i teksteve mësimore universitare mbeten të pa-përditësuara me literaturën e fundit bashkëkohore dhe kjo është një nga sfidat e përmirësimit të arsimit të lartë shqiptar.

Së treti, një shqetësim i vënë në dukje shpeshherë janë edhe bibliotekat e varfra në materiale dhe mungesa e aksesit në databaza ndërkombëtare si në universitetet publike ashtu edhe në ato private. Ministritë e Arsimit dhe vetë universitetet duhet të marrin masa që kjo gjendje të ndryshohet. Kolegë të Institutit Alb-Shkenca mundet të ofrojnë ndihmesën e vet në transferimin e fondeve të librave nga vende dhe institucione të tjera, dhe të këshillojë në lidhje me databazat më të përshtatshme.

Këtë vit në Shqipëri është folur shumë për reformën në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe ka dy komisione që punojnë në këtë drejtim, përkatësisht Komisioni për Reformën në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (KALKSH) dhe Komisioni i Ekspertëve për Reformën në Sistemin e Shkencës (KRSH). Dy raporte janë përgatitur nga KALKSH në prill dhe korrik 2014 dhe një nga KRSH në qershor 2014. IASH ka bërë komentet e veta në raportin e parë të prillit 2014 të KALKSH-së, të cilat edhe janë konsideruar në raportin përfundimtar të korrikut 2014.

Fjala reformë është një fjalë shumë e ngarkuar dhe nënkupton ndryshime të mëdha apo thelbësore në një sistem. Por sistemi i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor është i atillë që pranon ndryshime graduale dhe nuk reagon mirë ndaj ndryshimeve të mëdha apo radikale, sic e ka provuar edhe vetë historia e ndryshimeve që i janë bërë këtij sistemi në Shqipëri gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit. Në

fakt, zhvillimet e fundit në Shqipëri nuk janë reformë, por thjesht zbatim i ligjit dhe kontroll cilësie ndaj institucioneve të arsimit të lartë, disa nga të cilët ishin kthyer në zyra shitje diplomash fiktive. Numri i institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri është një rekord për librin Guinness. Sa për ilustrim, Norvegjia, shteti ku punoj, me sipërfaqe 300 mijë kilometra katrorë dhe pesë milion banorë ka tetë universitete, të gjitha publike. Shqipëria me sipërfaqe dhjetë herë më të vogël dhe tre milion banorë ka dymbëdhjetë universitete publike dhe shtatë private! Inflacioni është i qartë!

Masivizimi i pastudiuar i arsimit të lartë dhe mungesa e kontrollit të cilësisë ka shkaktuar një rënie të nivelit të arsimit të lartë. Në të njëjtën kohë, puna kryesore e stafit në universitetet tona është mësimdhënia. Përvec avancimit me tituj dhe përmbushjes së kriterëve formale nuk ka asnjë incentiv tjetër për të bërë kërkim shkencor dhe në fakt as edhe kushte minimale për këtë qëllim. Ky është një problem i madh, efekti i të cilit do të ndihet sepse një pedagog që nuk ka mundësi dhe kohë të bëjë kërkim dhe të përditësohet me literaturën e fundit nuk do të transmetojë nivelin e duhur të njohurive tek studentët e vet.

Raporti i korrikut i KALKSH-së, ai përfundimtar, përmban disa ide mjaft të mira në lidhje me drejtimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, të bazuara në një studim të hollësishëm të situatës së arsimit të lartë në Shqipëri që nga viti 1990 dhe trendet botërore.

Mesazhi personal

Së fundmi, dëshiroj të jap një mesazh personal për të gjithë kolegët këtu në sallë në lidhje me funksionin tonë si bartës të dijes dhe misionit civilizues të shoqërisë sonë.

Neve na është besuar një mision fisnik, ai i edukimit të brezave të rinj me dijet e nevojshme shkencore dhe të punës për përmirësimin e kushteve shoqërore, ekonomike dhe kulturore të shoqërisë. Përveç dijeve solide shkencore ne duhet t'u mësojmë studentëve tanë edhe etikën e punës dhe integritetin personal. E këto cilësi duhet t'i reflektojmë edhe vetë me punën dhe shembullin tonë.

Duke ju uruar të gjithëve suksese në punën tuaj dhe punime të mbara konferencave të vecanta shkencore që do të organizohen në dy ditët e ardhshme, ju falënderoj për interesin tuaj në punën e Institutit dhe ju ftoj t'i bashkoheni aktiviteteve dhe qëllimit tonë për përmirësimin e nivelit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në hapësirën shkencore shqiptare dhe bërjen e asaj pjesë të denjë të hapësirës shkencore europiane dhe botërore.

Ju faleminderit për vëmendjen.

Takimet dhe botimet shkencore të Institutit Alb-Shkenca, Eshref Januzaj, Zv. Drejtor i IASH

Instituti mbarëkombëtar Alb-Shkenca, ka arritur që brenda pak viteve të organizojë takimet më të mëdha shkencore që mbahen në trojet shqiptare, në të cilat përfshihen studiues nga të gjitha vendet në rajon ku jetojnë shqiptarët si dhe shkencëtarë shqiptarë që jetojnë e punojnë në botë. Në këto takime vjetore janë paraqitur gjithmonë e më shumë punime nga një spektër i gjere shkencash (mbi 10 konferenca shkencore gjatë një Takimi vjetor).

Qëllimi kryesor i organizimit të këtyre konferencave shkencore është ofrimi i një forumi diskutimi midis shkencëtarëve shqiptarë nga rajoni dhe kolegëve të tjerë nga vendet e ndryshme të botës. Rëndësia e veçantë e Takimeve të Institutit Alb-Shkenca është mundësia që u jepet edhe studiuesve dhe shkencëtarëve të rinj që të paraqesin punët e tyre shkencore dhe t'i diskutojnë ato me kolegë të tjerë nga rajoni dhe bota.


Krahas konferencave shkencore dhe paraqitjes së punimeve në to, IASH boton revistën e vet të rregullt shkencore AKTET, në të cilën publikohen punimet e plota të paraqitura gjatë një konference. Kjo revistë publikon vetëm punimet e recensuara dhe të pa botuara diku tjetër.

Rëndësia e një punimi shkencor rritet vetëm nëse ai publikohet dhe lexohet nga shkencëtarë të tjerë në mbarë botën. Nga leximi i punimit, i rritet reputacioni edhe revistës shkencore ku punimi botohet, sikurse dhe vetë autorëve të punimit (shih Fig. 1).


Albanian Papers (AlPa)

Që punimet shkencore të mos mbeten të shpërndarë si “ishuj të vetmuar” por të jenë të mirëintegruara dhe të qasshme nga çdokush, nevojitet publikimi elektronik i tyre.

Instituti Alb-Shkenca, ndoshta si e para organizatë shkencore në rajon, e përdor prej disa vitesh sistemin elektronik ALPA: Albanian Papers (alpa.mali-it.eu), përmes të cilit është krijuar mundësia e rrjetëzimit të dijes dhe hulumtimit shkencor shqiptar si dhe integrimi i kësaj dijeje në një bazë të dhënash, përmes të cilës ofrohet edhe mundësia e publikimit dhe indeksimit të punimeve shkencore shqiptare



në botë. Deri tani, përmes sistemit ALPA është arritur që të indeksohen në Google Scholar të gjitha punimet e botuara aktualisht në gjithë numrat e revistës sonë shkencore AKTET (Fig. 2).




Përveç indeksimit të punimeve shqiptare, përmes sistemit ALPA mundësohet edhe menaxhimi sa më i mirë i punëve të konferencave shkencore dhe revistës AKTET. Prej disa vitesh, punimet shkencore puer t'u paraqitur në Takimet vjetore të IASH pranohen tërësisht vetëm nëpërmes sistemit ALPA, gjë që lehtëson shumë punën recensuese dhe redaktuese të tyre.

Për autorët, ALPA ofron mundësinë që ata të dërgojnë

punimet e tyre përmes Internet-it në çdo kohë. Në këtë rast formatit të punimeve u bëhet një kontroll paraprak bazuar në rregullat e një konference apo reviste shkencore. Në këtë mënyrë mundësohet dërgimi i punimeve më cilësore, të cilat më pas, përmes sistemit ALPA, do të indeksohen dhe referencohen edhe në baza të tjera të dhënash në Internet.

Redaktorëve të një reviste apo konference shkencore, ALPA u lehtëson punën menaxhuese të punimeve tej mase, duke i ndihmuar gjatë tërë procesit të pranimit, recensimit, redaktimit dhe botimit të punimeve.

Edhe recensimi i punimeve që janë regjistruar në ALPA bëhet në mënyrë automatike, duke u mundësuar recensuesve të bëjnë vlerësimin e punimeve përmes një formulari online, pa pasur nevojë dërgimin fizik apo përmes postës elektronike të recensioneve (Fig. 3).



Një ndër përparësitë e menaxhimit elektronik të punimeve përmes sistemit ALPA është edhe gjenerimi automatik i dokumenteve me rëndësi për një revistë shkencore apo konferencë: statistika të ndryshme, gjenerimi i librit të abstrakteve, gjenerimi dhe dërgimi automatik i certifikatave të pjesëmarrjes dhe paraqitjes së punimeve në konferenca, kontrolli i cilësisë dhe statistika në kohë reale për numrin e punimeve të derguara, të pranuar/refuzuara, autorët etj.

- Regjistrimi online i autorëve
- Dërgimi online i punimeve nga vetë autorët
- Menaxhimi i procesit të recensimit online
- Redaktimi i punimeve online nga redaktorët e konferencave apo revistave shkencore
- Gjenerimi i statistikave nga organizatorët në kohë reale vetëm me një klikim
- Lista e plotë e autorëve në çdo kohë
- Lista aktuale e punimeve në çdo kohë
- Lista e qyteteve dhe shteteve nga janë autorët
- Numri i punimeve për çdo autor në kohë reale
- Gjenerimi automatik i librit të përmbledhjeve
- Gjenerimi automatik i certifikatave në formatin Pdf
- Indeksi në Google Scholar etj.


Statistika të gjeneruara nga ALPA në lidhje me Takimet shkencore të IASH

Takimi Vjetor 2014


- Konferenca shkencore: 10
- Simpozium shkencor: 1
- Punime: 572
- Autorë: 1068
- Shtete: 23
- Qytete: 77
- Autorë me 1 punim: 887
- Autorë me 2 punime: 157
- Autorë me 3 punime: 24
- Përmbledhje me 1 autor: 234
- Përmbledhje me 2 autorë: 139
- Përmbledhje me 3 autorë: 104
- Përmbledhje me 4 autorë: 56
- Përmbledhje me 5 autorë: 21
- Përmbledhje me 6 autorë: 11
- Përmbledhje me 7 autorë: 1
- Përmbledhje me 8 e më shumë autorë: 5

Takimi Vjetor 2013


- Konferenca shkencore: 10
- Punime: 465
- Autorë: 1031
- Shtete: 15



Konferencat shkencore dhe punimet e paraqitura




Shtetet nga vinin studiuesit pjesmarrës në Takim



Shkencëtarët dhe shkencëtarët në Takimin 2013

Struktura organizative e IASH-së dhe hapat për anëtarësimin e plotë në të



- Kërkesa për anëtarësim
- Procesi i anëtarësimit
- Dërgimi i CV-së
- Miratimi i CV-së nga stafi drejtues i Seksionit
- Njoftimi për pranimin
- Pagesa e kuotës së anëtarësisë

Kush lejohet të aplikojë për anëtarësim në Institut?

1. Studiues të cilët paraqesin listën e punimeve të tyre shkencore
2. Pedagogë universitetesh
3. Studentë doktorature dhe masteri

Botimet periodike të Institutit Alb-Shkenca

Robert Magari, Ph.D.

Kryeredaktor i revistës AKTET

AKTET është një revistë ndërkombëtare interdisiplinare e regjistruar në International Standard Serial Number Center (ISSN 2073-2244). Ajo pranon vetëm punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për përparimin e shkencës dhe i krijon mundësinë shkencëtareve që punojnë në institucionet akademike shtetërore, apo industri që të botojnë punën shkencore e në të njëjtën kohë të shkëmbejnë përvojën dhe mendime në lidhje me objektivat e tyre kërkimore-shkencore. Krahas originalitetit të punimit, AKTET i kushton rendësi të veçantë vlerave aplikative si dhe kontributit konkret të punimeve në zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë.

AKTET drejtohet nga Këshilli Botues i përbërë prej kryeredaktorit, redaktorëve të fushave disiplinore të veçanta, si dhe redaktorëve teknikë. Anëtarët e Këshillit Botues punojnë në institucione akademike-shkencore në vende të ndryshme të botës dhe përfaqësojnë nivelin më të lartë të shkencës.

Përveç përbërjes ndërkombëtare, Këshilli Botues ndjek procedura të krahasueshme me botimet më të mira ndërkombëtare për botimin e punimeve. Redaktori cakton dy recensentë në bazë të ekspertizës dhe mundësisë. Procesi i recensimit është double-blinded ku si autori ashtu dhe recesenti nuk njohin identitetin e njeri-tjetrit. Dorëshkrimi i dërgohet recensentëve pa emrat e autorëve, pra pa faqen e parë ku ndodhen zakonisht emrat e autorëve. Recensentëve ju kërkohet gjithashtu të plotësojnë një formular me vlerësimin dhe rekomandimet e tyre. Redaktori njofton autorin për vendimin, e shoqëron këtë njoftim me pjesët 2 dhe 3 të formularit të recensës të plotësuar nga recensenti dhe nëse është e aplikueshme me afatin e kthimit të punimit të korrigjuar. Redaktori vendos ta kalojë punimin e korrigjuar edhe një herë nëpërmjet procesit të recensimit ose vendos për pranimin përfundimtar në bazë të informacionit të parashtruar.

Të gjitha komunikimet ndërmjet autorëve, redaktorëve dhe recensentëve bëhen në mënyrë elektronike. Autorët duhet të dërgojnë dorëshkrimet e tyre nëpërmjet sistemit elektronik ALPA. Të gjitha dorëshkrimet ruhen në këtë sistem nga ku redaktorët e fushave të veçanta mund të fillojnë procesin e recensimit. Sistemi ALPA jo vetëm që rrit

efektivitetin e procesit por edhe bën të mundur eliminimin e gabimeve, rritjen e saktësisë dhe garanton transparencën.

AKTET botohet në vëllime dhe numra për secilin vëllim. Punimet e një viti përmbledhen në një vëllim ndërsa punimet e fushave të njëjta/ngjashme përmbledhen në një numër. Tabela 1 tregon botimet në vite kurse Figura 1 numrin e dorëshkrimeve të dërguara për secilin vit.

Tabela 1. Botimet në vite

Volumi	Viti i Botimit	Numra
Vol I	2008	2
Vol II	2009	3
Vol III	2010	5
Vol IV	2011	4
Vol V	2012	4
Vol VI	2013	5
Vol VII	2014	4




Figura 1. Dorëshkrime të dërguara

Ritmi i pranimit të dorëshkrimeve të dërguara në vite jepet në Tabelën 2 si dhe Figurën 1. Nuk duket të ketë ndonjë tendencë të veçantë për pranimin e punimeve nga viti në vit. Ndryshimet varen kryesisht nga prurja dhe niveli i punimeve

për atë vit të caktuar. Mesatarja e pranimit deri tani është 59.1%, kurse mesatarja e pranimit e rregulluar për numrin e punimeve për çdo vit është 55.5%

Tabela 2. Pranimi i punimeve

Volumi	Derguar	Pranuar	% Pranimi
Vol I	39	28	71.8%
Vol II	141	92	65.2%
Vol III	182	95	52.2%
Vol IV	273	132	48.4%
Vol V	274	135	49.3%
Vol VI	142	101	71.1%
Vol VII	125	70	56.0%




Figura 2. Pranimi i punimeve

Instituti Alb-shkenca ka ndërmarrë krijimin e një sistemi të kërkimit online plotësisht e integruar me kërkimet në platformat e njohura ndërkombëtare. Ky sistem do të mundësojë që punimet e botuar në revistën AKTET të gjenden në internet dhe në të njejtën kohë të arrijë formimin e një faktori impakti (*impact factor*) për vetë revistën.

Synimet për të ardhmen e AKTEVE konsistojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të revistës që ti shërbejë në mënyrë sa më efektive shkencëtarëve dhe rritjes së nivelit të punës shkencore.

• Seksioni i Filologjisë, Historisë dhe Kulturës i Institutit Alb-Shkenca duke qenë në rrjedhë me nevojën e publikimit të punimeve shkencore të anëtarëve të IASH-së, ngritjen e cilësisë shkencore të punimeve të tyre, si dhe përfshirjen e studimeve shqiptare në rrjedhat e përgjithshme shkencore botërore prej vitit 2013 ka nisur të nxjerrë (në Internet dhe në letër) revistën ANAS. Kjo revistë do të botohet katër herë në vit. Deri tani janë botuar tre dyndumështa: 1-2/2013, 3-4/2014 dhe 5-6/2014. Deri në fund të vitit 2014 pritet të dalë edhe numri 7-8/2014.

Shkenca, Faktor i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë - Roli i Bioteknologjisë

Prof.Dr. Bajram Berisha

Hyrje

Zhvillimi i përgjithshëm, që i shërben nevojave të brezit aktual pa i rrezikuar nevojat e brezave të ardhshëm në planetin tonë, përkufizohet me emërtimin “zhvillim i qëndrueshëm” (ang. *sustainable development*). Zhvillim i qëndrueshëm (ZhQ) lidhet në konceptin, i cili u përdor për herë të parë në Gjermani në fillimet e shekullit XVIII për të karakterizuar problematikën e menaxhimit të pyjeve [1]. Zhvillimi i qëndrueshëm aktualisht paraqet potencialin për zgjidhjen e problemeve të ndryshme me të cilat ballafaqohet shoqëria bashkëkohore në të gjitha nivelet e organizimit [2,3].

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm

Zhvillim i qëndrueshëm si problematikë komplekse, sot trajtohet në nivelet më të larta politike dhe shkencore ndërkombëtare. Zgjidhjet për realizimin e ZhQ janë natyrisht shumë komplekse, sepse ato duhet të jenë në harmoni të plotë me qëllimet dhe interesat ekonomike, sociale, politike, kulturore, mjedisore etj. (Fig. 1). Kjo për arsye se njeriu, në të kaluarën, për një kohë të gjatë, i ka shfrytëzuar burimet e planetit në mënyrë shumë intensive, pa e menduar se nuk ka në dispozicion një vendbanim tjetër rezervë.

Dëmtimet e planetit, shpeshherë vështirë të rikthyeshme në nivel global (ndotja e ajrit, ujit, tokës), që kryesisht janë shkaktuar nga shfrytëzimi i njëanshëm dhe joracional i energjisë, e kanë rrezikuar të ardhmen e njeriut dhe kanë rezultuar, përveç të tjerave, edhe në zhdukjen e një numri të madh të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve. Prandaj është detyrë e shkencës bashkëkohore që të përballet me vështirësitë që hasen nëpër fusha të caktuara dhe të gjejë zgjidhje të qëndrueshme për ndryshimin e këtyre trendeve [3].

Bazuar në parimet e diskutuara të zhvillimit të qëndrueshëm, në këtë artikull, duke u fokusuar vetëm në sfidën globale të sigurimit të ushqimit, do të shpjegohet roli i shkencës së bioteknologjisë në zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror.




Figura 1. Shtyllat kryesore (zhvillimi ekonomik, social dhe ekologjik) të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm (modifikuar nga www.dragageshk.com)

Roli i bioteknologjisë si shkencë bashkëkohore

Bioteknologjia, shkenca e cila integron në mënyrën më të përsosur botën e gjallë dhe teknikat më të avancuara të të gjitha disiplinave shkencore të biologjisë (Fig. 2), për të lehtësuar jetën e njeriut i është përgjigjur me kohë të gjitha sfidave. Bioteknologjia është shkencë e cila nga qelizat e gjalla ose organizmat si tërësi (mikroorganizmat, bimët dhe shtazët), duke aplikuar teknologjitë dhe bashkëkohore të shkencave të ndryshme (gjenetikës, biologjisë molekulare, mikrobiologjisë, biokimisë etj.), prodhon produkte të nevojshme dhe të domosdoshme për jetën e njeriut. Bioteknologjia paraqet një teknologji kyçe e cila do të jetë në funksion të sfidës së shekullit tonë për të prodhuar ushqim të mjaftueshëm dhe cilësor në njërën anë, ndërkohë në anën tjetër për të siguruar një ambient të përshtatshëm jetësor. Ajo është shkencë interdisciplinare e cila do të lidhë në mënyrë funksionale fusha të ndryshme të aplikimit siç janë: bujqësia, teknologjia ushqimore, mjekësia, mbrojtja e mjedisit etj. [4].




Figura 2. Bioteknologjia - shkenca e cila integron botën e gjallë dhe teknikat më të avancuara të të gjitha disiplinave shkencore të biologjisë (modifikuar sipas [4])


Bioteknologjia moderne dhe roli i saj në sfidën globale të sigurimit të ushqimit

Shekulli i ri, shikuar nga shumë aspekte, duket se do të jetë shekulli i shkencës së bioteknologjisë moderne. Sikur çdo teknikë e re, që zhvillohet me shpejtësi të madhe, edhe bioteknologjia moderne kohë pas kohe po has në skepticizëm (mosbesim ndonjëherë të arsyeshëm) nga anë të ndryshme, kryesisht për arsye të mungesës së informacioneve të nevojshme. Prandaj, mbetet detyrë dhe obligim i shkencëtarëve që merren më këtë fushë shkencore që t'i shpjegojnë deri në detale përparësitë dhe të metat (rreziqet eventuale) e bioteknologjisë, që na paraqitet si imperativ i kohës. Është e rëndësishme që aplikimi i bioteknologjisë në perspektivë të bazohet në një konsensus të gjerë të shoqërisë, i cili do të mbështetet në interesa të përgjithshëm ekonomikë, socialë, shëndetësorë dhe ekologjikë, në mënyrë që në një të ardhme të afërt të arrijmë një akceptancë të përgjithshme për këtë shkencë të rëndësishme të së ardhmes [4,5].

Gjate këtij shekulli njerëzimi do të përballët me shumë probleme dhe pyetje, përgjigja e të cilave ndoshta do të mund të gjendet pikërisht në zhvillimin e bioteknologjisë moderne. Ndër sfidat e para të shkencës së këtij fillimshekulli do të jetë sigurimi i mjaftueshëm i ushqimit si zhvillim i qëndrueshëm.

Trendet e rritjes së popullsisë globale

Për të shpjeguar konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rolin e shkencës së Bioteknologjisë le t'i referohemi pritjeve të rritjes së popullsisë botërore në planetin tonë. Derisa në vitin



**Figura 3. Trendet e rritjes së numrit të popullsisë në botë
(modifikuar sipas [5])**

Sipas të dhënave të OKB-së, rritja vjetore e popullsisë botërore kalon 80 milionë banorë dhe pritet që, rreth vitit 2050, popullsia globale të jetë mbi 9 miliardë banorë. Natyrisht, me rritjen kaq të shpejtë të popullsisë, doemos rriten edhe nevojat dhe kërkesat e njeriut dhe rrjedhimisht edhe të ardhurat, të cilat rrjedhin nga shfrytëzimi i njëanshëm i burimeve në planetit tonë. Sigurimi i ushqimit të mjaftueshëm në kushte të shtimit të tillë marramendës të njerëzimit dhe në anën tjetër zvogëlimit rapid të sipërfaqeve tokësore në botë, do të jetë njëra nga sfidat më të rëndësishme të bioteknologjisë moderne [4].

Trendet globale të zvogëlimit të sipërfaqeve tokësore që shfrytëzohen për bujqësi

Shtimit të popullsisë botërore me rritje ekstreme superekspone nallat nuk i shihet fundi. Arsye e mjaftueshme për një dozë pesimizmi! “monokultura” njeri, zgjeron për çdo ditë hapësirat e veta jetësore në llogari të florës dhe faunës natyrore por edhe në llogari të zvogëlimit të shpejtë të sipërfaqeve bujqësore dhe blegtorale [4]. Si rezultat logjik i këtij fenomeni paraqitet një rënie rapide e sipërfaqeve bujqësore për kokë banori, në të gjithë rruzullin tokësor! Parashikimi i sipërfaqes bujqësore në dispozicion për kokë banori deri në vitin 2025 duke pasur parasysh shkallen e rritjes së popullsisë, tregon gjithashtu një rënie rapide, duke arritur në pika kritike (Fig. 4).




Figura 4. Parashikimi i sipërfaqes bujqësore në dispozicion për kokë banorit deri në vitin 2025 duke pasur parasysh shkallën e rritjes së popullsisë (Modifikuar sipas [6])

Në këto kushte, për të arritur qëllimin parësor, atë të një shoqërie me mirëqenie të përgjithshme dhe ekologjikisht të qëndrueshme, duhet investuar shumë më tepër në kërkime të thelluara shkencore me karakter multidisiplinor dhe multidimensional. Kërkimet shkencore mundësojnë operacionalizimin e elementeve të ZhQ, ofrojnë instrumentet për vlerësim dhe analizë kritike, respektivisht vënë në pah rrjedhojat eventuale të procesit, si dhe ofrojnë modele për menaxhimin e proceseve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Natyrisht, në të tilla raste komplekse siç është siguri i ushqimit (për popullsinë globale që aktualisht po dyfishohet brenda afateve gjithnjë e më të shkurtra kohore), ndërkohë që toka bujqësore po zvogëlohet me shpejtësi marramendëse, kërkohet angazhimi i shkencëtarëve të fushave të ndryshme (natyrore, teknike, mjekësore, etj) për të gjetur zgjidhje të cilat shpeshherë janë vështirë të realizueshme. Është e njohur se edhe sot e kësaj dite në disa regjione të botës, nga uria vdesin dhjetëra-mijëra fëmijë, ndërsa sipas organizatës për ushqim dhe agrikulturë të OKB-së FAO [7], qindra mijëra banorë të planetit tonë shkojnë të uritur për çdo ditë në shtrat. Pra e drejta e njeriut për ushqim të mjaftueshëm nuk është plotësuar ende!

Ndërkohë, shkencëtarët shtim të mëtejshëm të numrit të popullsisë, që do të mund të përcillet sipas parashikimeve me shtimin e mëtejshëm të njerëzve të uritur [8]. Ky eksplozion marramendës i numrit të popullsisë botërore nuk kufizohet vetëm me problemin e mungesës kronike të ushqimit. Një problem tjetër i madh që përcjell shtimin e popullsisë është edhe prodhimi gjithnjë e në rritje i mbeturinave, pra ndotja e ambientit jetësor, e ajrit, ujit dhe tokës. Edhe për këtë problem nuk është aspak lehtë të gjendet zgjidhja, duke pasur parasysh sasitë e mëdha, por edhe cilësitë, shpesh herë me rrezikshmëri të shumëfishtë të ndotësve bashkëkohorë!

Në këtë situatë aspak të përshtatshme për perspektivën e të ushqyerit, por edhe për mbrojtjen e mjedisit, pritët që përgjigjen ta jep bioteknologjia, cila sipas traditës ne vete

integron inovacionin dhe fuqinë vepruese në drejtim të zhvillimit të strategjive të reja për shfrytëzimin eficient të tokës, energjisë dhe burimeve gjithnjë në zvogëlim [4].

Trendet aktuale të zhvillimit të Bioteknologjisë si shkencë bashkëkohore

Në përmbushjen e sfidës globale – sigurimin e ushqimit për të gjithë njerëzit në planet, një kontribut shumë të madh po jep shkencë bashkëkohore e në veçanti ajo e bioteknologjisë.

Arritjet e shpejta shkencore në fushën e biologjisë molekulare dhe inxhenjeringut gjenetik që ndodhën në dekadat e fundit të shekullit të kaluar, mundësuan një zhvillim revolucionar të bioteknologjisë, e cila ndikoi fuqishëm në hapjen e fushave të reja të aplikimit në bujqësi, mjekësi, industri, teknologji, mbrojtjen e mjedisit dhe fusha të tjera. Kjo shkencë paraqet një fushë të karakterit multidisiplinor e cila duke shfrytëzuar njohuritë shkencore bazë të akumuluar në shekuj, si dhe duke aplikuar arritjet teknike më bashkëkohore, po mundëson ndryshimin e shpejtë të cilësive të dëshiruara të organizmave të ndryshëm. Të gjitha këto kanë mundësuar ndryshimet që mund të bëhen sot në nivelin e gjenomit (duke modifikuar bazën gjenetike); ndërsa qëllimi i këtyre ndryshimeve mbetet përmirësimi i vazhdueshëm i cilësive të caktuara të organizmave të veçantë (Fig. 5). Këto modifikime gjenetike bëhen duke ndryshuar gjenomin, gjegjësisht duke futur një gjen “të huaj” në gjenomin e një organizmi tjetër, dhe organizmat e tillë njihen me emrin Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht (OMGj) ose organizmat transgjenik. Modifikime të gjenomit tashmë janë ndërmarrë në një numër të madh organizmash (bimorë, shtazorë dhe mikroorganizmav) të ndryshëm gjë që për një kohë të shkurtër, ka mundësuar shumëfishimin e prodhimtarisë globale të produkteve ushqimore (me origjinë bimorë, shtazorë etj.).




Figura 5. Bioteknologjia tradicionale: (A) Kryqëzimi i organizmave të llojit të njëjtë me veçori të ndryshme për të përfituar pasardhës me cilësi të dëshiruara. (B) Bioteknologjia moderne: Transferi i qëllimshëm i gjeneve të “huaja” në gjenomin e një organizmi të caktuar (OMGj ose organizmat transgjenike), me qëllim përmirësimin e cilësive të veçanta të organizmave të caktuar (modifikuar sipas [8])

Qëllimi i bioteknologjisë moderne është që njohuritë fundamentale nga shkencat e natyrës dhe të arriturat më të reja të shkencave teknike t'i integrojë me qëllim të zhvillimit të teknologjive të reja, në mënyrë që të bëjë të mundur prodhimin e sasive të mjaftueshme të produkteve ushqimore me vlera të larta ushqyese dhe cilësi të dëshiruara për shëndetin e njeriut. Një vend të veçantë zë këtu prodhimi i produkteve me komponentë biofunktionale, siç janë antibiotiket, enzimët, antioxidantët, peptidet biologjikisht aktive etj. Në fushën e farmacisë dhe mjekësisë, bioteknologjia tashme ka një përvojë të gjatë duke filluar me prodhimin e vaksinave dhe antibiotikeve në shekullin e kaluar dhe deri te terapia e gjeneve [9] si dhe mundësia e ri-programimit të qelizave somatike në qeliza embrionale (burimore) që po zhvillohet aktualisht [10].

Sot më shumë se kudoherë në historinë e njerëzimit, shkencë ka nevojë për inovatorë dhe vizionarë të fuqishëm të cilët, do të krijojnë strategji afatgjate, në mënyrë që gjeneratat tona pasardhëse të mund të trashëgojmë mjedisin jetësorë, të cilin vetëm përkohësisht e kemi huazuar nga paraardhësit-gjyshërit tanë! Natyrisht metodat moderne të shkencave të natyrës të kombinuara me teknikat inovative dhe me automatizimin e proceseve teknologjike hapin perspektiva shumë premtuese deri tani thuajse të panjohura jo vetëm për zhvillimin e produkteve të reja ushqimore, por edhe për zhvillime të tjera të cilat do të mundësojnë jo vetëm të ushqyerit adekuat, por edhe mbrojtjen adekuate shëndetësore si dhe ruajtjen e mjedisit si pjesë shumë të rëndësishme të jetës.

Shkencë e bioteknologjisë faktor i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror

Kështu, zhvillimi i shkencës së bioteknologjisë, përmes të arritave bashkëkohore shkencore të diskutuara më lartë (prodhimi i OMGJ-ve etj), po mundëson prodhim të mjaftueshëm të ushqimit si „zhvillim të qëndrueshëm“, gjë që paraqet një imperativ për t'i dhënë përgjigje rritjes së shpejtë të popullsisë së planetit tonë, ndërkohë që sipërfaqja e tokës bujqësore po humbet në mënyrë të pakthyeshme.

Si çdo inovacion tjetër edhe OMGJ-të sjellin me vete një dozë skepticizmi, që më shumë vie nga mungesa e informacionit të mjaftueshëm sesa nga ndonjë rrezik konkret që këto organizma paraqesin për popullatën njerëzore. Nëse shikohen dy shembuj prominente në historinë e OMGJ-ve, ai i “Misrit Bt” (Bt corn) dhe “orizit të artë” (Golden rice), i pari i krijuar si alternativë për të evituar përdorimin e pesticideve ndërsa i dyti si burim i prekursorit të vitaminës-D. Është tashmë e qartë se arsyeja e gjenerimit të OMGJ-ve është krejtësisht në harmoni me kërkesat dhe nevojat e njeriut moderne, ndërkohë që bazuar në të arriturat aktuale shkencore, deri më sot nuk ka ndonjë evidencë për

efekte të caktuara negative. Megjithatë, duhet potencuar se sipas FAO, shkencë nuk mund të deklarojë asnjë teknologji të re krejtësisht pa rrezik, prandaj është obligim i përbashkët shoqëror që të vendoset se kur dhe ku këto produkte (ose produkte tjera të bioteknologjisë), mund të paraqesin ndonjë rrezik eventual të çfarëdo natyre.

Sigurimi i ushqimit aktualisht është vetëm njëra nga sfidat e njerëzimit, prandaj intensifikimi i kërkimeve shkencore edhe në fushat e tjera të shkencës, mbetet faktori kyç për sigurimin e një „zhvillimi të qëndrueshëm“ shoqëror, ekonomik, ekologjik dhe kulturor, i cili nuk do të kërcënonte të ardhmen e brezave pasardhës në planetin tonë.

Literatura

- [1]. Klaus-Georg Wey: Umweltpolitik in Deutschland: kurze Geschichte des Umweltschutzes in Deutschland seit 1900. Westdeutscher Verlag, Opladen 1982, s. 157.
- [2]. Mensah AM & Castro LC. Sustainable resource use & sustainable development: a contradiction?! <http://www.zef.de/fileadmin/downloads/forum...Castro.pdf>
- [3]. Hartmut B. Indicators for Sustainable Development: Theory, Method, Applications. The Internat. Institute for Sustainable Develop. <https://www.iisd.org/pdf/balatonreport.pdf>
- [4]. Berisha B. & Tafaj M. Bioteknologjia – shkencë në shërbim të sfidave të së ardhmes. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit. Educologia 2008;2: 129-141.
- [5]. Kern M, Geiß J, B. Nahrungsmittel-, Futtermittel- und Biomassepron im Spannungsfeld von regionalen und globalen Entwicklungen (www.suedniedersachsenstiftung.de).
- [6]. Industrieverband Agrar e.V. (IVA) (www.iva.de).
- [7]. FAO - Food and Agriculture Organization (www.fao.org)
- [8]. Anwer N. Biotechnology for sustainable development. www.sciencevision.org.pk
- [9]. Saueressig MG, Neto AM, Fortis EA, Westphal D, Edelweiss MI, Meurer L, Matte U. Vascular endothelial growth factor gene therapy induces early re-establishment of canine bronchial circulation. Eur J Cardiothorac Surg. 33:717-22, 2008.
- [10]. Zhang Z, Wang X, Wang S. Isolation and characterization of mesenchymal stem cells derived from bone marrow of patients with Parkinson's disease. In Vitro Cell Dev Biol Anim. 44(5-6):169-77, 2008.



Takimi i 10-të jubilar
i Institutit Alb-Shkenca do të mbahet
në Shkup në periudhën gusht-shtator
2015.

Ju ftojme që të merrni pjesë aktive
duke sjellë punimet dhe përvojën
tuaj studimore-shkencore në dobi
të të gjithë shoqërisë shqiptare.